



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshtor

Seanca plenare e Kuvendit
SP-087
Prishtinë, më 23, 24 dhe 29 dhjetor 2016

PROCESVERBAL

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 23, 24 DHE 29 DHJETOR 2016**

Seancën e drejtuan Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, i ndihmuar nga nënkryetari i Kuvendit, Xhavit Haliti.

Nënkryetari i hapi punimet e Kuvendit, sipas rendit të ditës të përcaktuar me vendim të seancës plenare të Kuvendit, datë 22 dhjetor 2016.

Ai procedoi me pikën e vetme të rendit të ditës:

1. Debat parlamentar lidhur me ndërtimin e murit në mënyrë ilegale në pjesën veriore të Mitrovicës, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Grupi Parlamentar i AAK-së e ka propozuar si çështje urgjente debatin lidhur me ndërtimin e murit në mënyrë ilegale në pjesën veriore të Mitrovicës, si dhe e ka propozuar për miratim një projektrezolutë, e cila u është shpërndarë deputetëve.

Më pas, z. Pal Lekaj, kryetar i Grupit Parlamentar të AAK-së, i propozoi Kuvendit që debati lidhur për këtë çështje të mbahet një ditë djetër me arësyetimin se ka shkuar koha shumë vonë që sot të zhvillohet ky debat, ndërsa grupet parlamentare PDK, LDK dhe “6+”, paraqitën qëndrimet e tyre që seanca t’i zhvillojë punimet sot.

Pastaj, kryetari i hodhi në votim të dy këto propozime dhe me shumicë votash u vendos që seanca t'i vazhdojë punimet.

Kryetari e ftoi z. Pal Lekaj, kryetar i Grupit Parlamentar të AAK-së, që në emër të propozuesit të debatit ta paraqesë dhe arsyetojë çështjen.

Kryetari i GP të AAK-së, Pal Lekaj, para deputetëve të Kuvendit në tërësi i shpaloj arsyet e kërkesës për këtë debat parlamentar, si dhe tha që Mitrovicës dhe Kosovës, në përgjithësi, i vjen rreziku nga ky mur i ndërtuar tani më në atë pjesë.

Gjithashtu, ai kërkoi nga kryeministri Mustafa dhe ministrja për Dialog, Edita Tahiri, që ta informojnë Kuvendin nëse kanë qenë në dijeni për ndërtimin e një muri të tillë. Ai vlerësoi gjithashtu, se pos murit, po ndërtohet edhe një objekt tjetër i dyshimtë. Këto dy veprime, sipas tij, po e presin të tretin, krijimin e Asociacionit të Komunave me shumicë serbe, duke përmbyshur, siç tha ai, panoramën e projektuar nga Serbia, krijimin e një shteti brenda shtetit të Kosovë.

Në fund, z. Lekaj i lexoi edhe disa rekomandime të tekstit të rezolutës, të cilat paraprakisht u ishin shpërndarë deputetëve. Diskutimi i z. Pal Lekaj është dhënë në transkript.

Më pas, kryetari hapi debatin në lidhje me ndërtimin e murit në mënyrë të paligjshme në pjesën veriore të Mitrovicës.

Lidhur me ndërtimin e murit në mënyrë ilegale në pjesën veriore të Mitrovicës diskutuan: Zenun Pajaziti, në emër GP PDK; Sadri Ferati, në emër të GP LDK; Glauk Konjufca, në emër GP LV; Valdete Bajrami, në emër të GP "Nisma"; Qerim Bajrami, në emër të GP "6+"; Isa Mustafa, kryeministër i Qeverisë; Kadri Vesli, kryetar i Kuvendit; Edita Tahiri, ministre për Dialog, si dhe deputetët: Sala Berisha-Shala, Ali Berisha, Aliu Sadriu, Rexhep Selimi, Albin Kurti, Time Kadriaj, Zafir Berisha, Xhevahire Izmaqi, Besa Gaxherri, Donika Kadaj-Bujupi, Hajdar Beqa, Ilir Deda, Shukrije Bytyçi, Anton Quni, Shaip Muja, Bekim Haxhiu, Teuta Haxhiu, Albulena Haxhiu, Rustem Berisha, Shukri Buja, Haxhi Shala, Ismajl Kurteshi, Shpejtim Bulliqi, Besa Baftiu, Driton Çausi, Lahi Brahimaj, Visar Ymeri, Raif Qela, Mytaher Haskuka, Fisnik Ismaili, Fatmir Shurdhaj, Armend Zemaj, Nait Hasani, Nuredin Ibishi, Bislam Zogaj, Fisnik Ismaili, Nehat Baftiu, Elmi Reçica, Blerta Deliu-Kodra dhe Xhavit Haliti, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryesuesi në fund të diskutimeve kërkoi nga Pal Lekaj që në cilësinë e propozuesit të paraqesë Propozim-rezolutën rreth debatit parlamentar lidhur me ndërtimin e murit në mënyrë ilegale në pjesën veriore të Mitrovicës.

Kryetari i GP AAK, Pal Lekaj, e paraqiti tekstin e propozim-rezolutës.

Kryetari i njoftoi deputetët se për ta hedhur në votim Propozim-rezolutën nuk ka kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje, andaj pas konsultimit me grupet parlamentare do të caktohet dita se kur do të votohet për të dhe për projektligjet e mbetura nga seanca paraprake.

Vazhdimi i mbledhjes plenare, më 29 dhjetor 2016

Kryetari i njoftoi deputetët se është arritur pajtueshmëri ndërmjet grupeve parlamentare në Kuvendin e Republikës së Kosovës që të miratohet një rezolutë për çështjen e ndërtimit të murit në mënyrë të paligjshme në pjesën veriore të Mitrovicës.

Kryetari më pas ia dha fjalën Pal Lekaj, kryetar i GP AAK, që ta paraqesë para deputetëve Propozim-rezolutën.

Deputeti Pal Lekaj e lexoi Propozim-rezolutën prej katër (4), të harmonizuar nga përfaqësuesit e grupeve parlamentare të PDK-së, LDK-së, LVV dhe AAK-së.

Lidhur me këtë Propozim-rezolutë diskutuan deputetët: Qerim Bajrami, Sabri Hamiti, Nuredin Ibishi, Armend Zemaj, Sadri Ferati, Zafir Berisha, Rexhep Selimi, Fatmir Rexhepi, Selvije Halimi, Vjosa Osmani, Zenun Pajaziti dhe Bekim Haxhiu, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim tekstin e Propozim-rezolutës.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për -----	74
Kundër -----	00
Abstenime -----	02

Kryetari konstatoi se Kuvendi i Republikës së Kosovës, me shumicë votash, në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të nenit 52, paragrafi 2 i Rregullores së Kuvendit, pas debatit të zhvilluar në seancën plenare të mbajtur më 23, 24 dhe 29 dhjetor 2016, lidhur me ndërtimin e murit në mënyrë ilegale në pjesën veriore të Mitrovicës, me propozimin e Grupit Parlamentar të AAK-së, mbështetur edhe nga grupet parlamentare: GP PDK, GP LDK, GP LVV dhe GP “Nisma”, miratoi këtë:

REZOLUTË

1. Të rrënohet muri ilegal në pjesën veriore të Mitrovicës, e kjo të ndodhë brenda muajit janar të vitit 2017.
2. Qeveria e Kosovës të angazhohet që organet kompetente për trajtimin e ndërtimeve pa leje t’i ndërmarrin të gjitha veprimet ligjore për murin që është në ndërtim e sipër në pjesën e urës së Ibrit, i njëjti të trajtohet si veprim politik dhe ndërtim pa leje.
3. Qeveria e Kosovës t’i ndërmarrë masat e nevojshme që të mos ndryshohet ura e Ibrit dhe e njëjta t’i përmbajë të gjitha elementet që i kishte para vitit 1999, e jo t’i shtohen elemente tjera ilegale, siç është muri dhe shkallët.

4. Të bëhet e mundur që qytetarët sa më parë të kthehen në pronat e tyre, në të dy pjesët e qytetit të Mitrovicës.

Kryetari i mbylli punimet e seancës plenare në orën 11:50.

Kryetari i Kuvendit:

Kadri VESELI

*Procesverbalin e hartoi:
Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale*